



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 531/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23/11/2020, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me nr. REF-77140-10-29-2020, me objekt: “Transporti i materialeve të dala nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me fond limit 76,455,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Artan Lenja”, pallati “4 A-M”, Ap.A1, kati I-rë, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, neni 42 e vijues”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.10.2020 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me nr. REF-77140-10-29-2020, me objekt: “Transporti i materialeve të dala nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me fond limit 76,455,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 09.11.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 16.11.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------------|
| 1. “4 A-M” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 2. “Biba - X” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 3. “Be - Is” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 4. “AL - Asfalt” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 5. “Ante - Group” sh.p.k. & ”Ferro” sh.p.k. | Skualifikuar; |

- | | |
|---|---------------|
| 6. “Eril B&B” sh.p.k. & ”Llazo” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 7. “Beqiri” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 8. “Colmbo” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 9. “Shendelli” sh.p.k. | Skualifikuar; |
| 10. “Shkëlqimi 07” sh.p.k. | Skualifikuar; |

II.4.Në datën 16.11.2020, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “4 A-M” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“- Për kandidatin 4 A-M, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë konstatoi se: Tek kriteret e veçanta të kualifikimit, për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma d -Licensë transporti (nëse mjeti është i marrë me qera duhet të jetë i pajisur me licensë transporti për transport mallrash për të tretë dhe me qera). Kandidati 4 A-M nuk e plotëson kriterin e mësipërme pasi i mungon licensa e transportit. KVO vendos që kandidati 4 A-M të mos kualifikohet”

II.5.Në datën 18.11.2020, operatori ekonomik ankimues “4 A-M” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Per sa me siper argumentojme se:

Ne kriteret e vecanta per kualifikim eshte kerkuar: Ne baze te ligjit 8308 dt. 18.03.1998 “Per Transportet Rrugore” i ndryshuar shoqeria duhet te disponoje dokumentacionin e nevojshem per mjetet motorike vetshkarkuese

-Policen per sigurimin e detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorrike per pergjegjesine ndaj paleve te treta

-Kontrollin teknik

-Lejen e qarkullimit

-Certifikate e kryerjes se operacionit teknik

-Certifikate transporti per transport mallrash.

-License transporti (nese mjeti eshte i marre me qera duhet te jete i pajisur me license transporti per transport mallrash per te trete dhe me qera)

Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk jane te shenuara ne rregjistra publike duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne pronesine/qirane dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Se pari, Shoqeria “4A-M” SHPK ka paraqitur ne oferte kontraten e qirase me nr. 7622 Rep nr.1332 Koi date 06.11.2020 te lidhur me shoqerine “Arjeil” SHPK per mjetin Kamion me targe AA 263 ML.

Ne dokumentet e ngarkuara ne sistemin e APP-se pervec kontrates se qirase, lejes se qarkullimit, certifikates se pronesise, aktit te kolaudimit, polices se sigurimit, certifikates se kryerjes se operacionit Teknik, taksas vjetore 2020 jane paraqitur edhe 2 dokumenta per transportin e mallrave. Specifikisht eshte paraqitur licenca Nr. 004/4, date 25.04.2019 per Transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit per ARJEIL SHPK si edhe certifikata Nr. 002 date 25.04.2019 per Transport mallrash per te trete dhe me qira brenda vendit per mjetin me targe AA 263 ML ne pronesi te shoqerise ARJEIL SHPK, dokumentacion ky qe i perket Qiradhenesit. Te gjitha dokumentat e listuar me siper jane te vlefshme dhe konform legjislacionit ne fuqi. Theksojme se te gjitha kerkesat e listuara me siper ne kriteret e vecanta per kualifikim jane plotesuar ne dokumentin e ngarkuar me emertim “Mjete me qera”.

Se dyti: Shoqëria 4 A-M SHPK ka paraqitur ne tender Licence me numer LN-9200-02-2015 per Transport rrugor nderkombetar mallrash per te trete e me qera. Ne veprimtarine e saj perfshihet transporti kombetar dhe nderkombetar i mallrave per te trete dhe me qira. Kjo licence gjendet ne dokumentin e ngarkuar ne sistemin e APP-se me emertim “Mjete ne pronesi”

Kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike te diet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se gezojne te gjitha kapacitetet ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale por te analizoje ne themel kapacitetet e ofertuesit ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilat vendosen kriteret e percaktuara.

Per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetin teknik te mjaftueshem per zbatimin e kontrates sikurse percaktuar ne nenin 46, pika 1, germa “b”, te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili shprehimisht thote: “Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmerine, per te zbatuar kontraten, sig eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates [...]”

II.6.Në datën 20.11.2020 autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “4 A-M” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se “Për kandidatin 4 A-M, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të kërkuar në fazën e parë konstatoi se: Tek kriteret e veçanta të kualifikimit, për kapacitetin teknik pika 2.3 gërma d -Licensë transporti (nëse mjeti është i marrë me qera duhet të jetë i pajisur me liçensë transporti për transport mallrash për të tretë dhe me qera). Kandidati 4 A-M nuk e plotëson kriterin e mësipërme pasi i mungon liçensa e transportit. KVO vendos që kandidati 4 A-M të mos kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 13, pika 2.3.d, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

“d. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion sipas Kodit Rrugor operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës për :

- Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 7.5-18 ton (cope 2)

- *Automjete vetshkarkuese me mase maksimale te autorizuar 18-40 ton (cope 6)*
- *Eskavator me goma 15-20 ton (cope 1)*
- *Eskavator 20-30 ton (cope 1)*
- *Eskavator 30-45 ton (cope 1)*

Në baze të ligjit 8308 dt.18.03.1998 “Për Transportet Rrugore” i ndryshuar shoqëria duhet të disponojë dokumentacionin e nevojshëm për mjetet motorike vetshkarkuese

-Policën për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta

-Kontrollin teknik

-Lejen e qarkullimit

-Certifikatë e kryerjes së operacionit teknik

-Certifikatë transporti për transport mallrash.

-Licensë transporti (nëse mjete është i marrë me qera duhet të jetë i pajisur me licensë transporti për transport mallrash për të tretë dhe me qera)

Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë/qiranë dhe librezat/te dhena teknike, ose ekuivalenti i tij/saj)

Për mjetet e përmendura mësipër, drejtuesit e tyre të kenë leje drejtimi përkatëse”

III.1.2. Nga verifikimet në dokumentacionin e paraqitur për procedurën e p[rokurimit object ankimi, konstatohet se operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër, ndër të tjera, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA214TT, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA216TT, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA024TT, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA637NX, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA640NX, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA641NX, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qira, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik dhe foto e mjetit AA605SB, në pronësi të subjektit “4 A-M” sh.p.k.
- Licencë LN-9200-20-2015, lëshuar nga QKL për subjektin “4 A-M” sh.p.k., me objekt “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qera”, shoqëruar me vendimin nr.18, datë 25.02.2015, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

- Kontratë qiraje, nr.7622rep., nr.1332kol., datë 06.11.2020, lidhur ndërmjet shoqërisë “Arjeil” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “4 A-M” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të mjetit Kamion me targë AA263ML, shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit, licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, certifikatë e kryerjes të operacionit teknik.

III.1.3. Në nenin 42, pika 1 e ligjit nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikohet se “Kriteret e kualifikimit dhe kriteret e vlerësimit hartohen sipas legjislacionit për prokurimin publik, për aq sa është e mundur dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.6. Në pikën 5 të nenit 28 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.
- d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”

III.1.7. Në pikën 2.1, të kapitullit I të Vendimit nr.325, datë 19.03.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar parashikohet se:

“2.1 Transporti i mallrave dhe udhëtarëve lejohet të kryhet, nga ndërmarrje të transportit, për të tretë ose me qira, vetëm kur janë pajisur me:

- a) licencën përkatëse në transportin rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve, brenda vendit;

b) licencën përkatëse në transportin ndërkombëtar rrugor, për të tretë ose me qira, të mallrave ose udhëtarëve”

III.1.8. Në Udhëzimin nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar parashikohet se:

“5. Licencë: leje për një periudhë të caktuar kohe dhe për një numër të pakufizuar udhëtimesh, për të kryer veprimtari transporti udhëtarësh dhe veprimtari transporti mallrash për të tretë dhe me qira brenda dhe/ose jashtë vendit.

9. Certifikatë: dokument që mbahet në mjet dhe që:

a) provon zotërimin e licencës për rastet e transporteve rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, që janë subjekt licencimi;

b) i jep një mjeti rrugor me motor, të drejtën e operimit në transportet rrugore të brendshme dhe ndërkombëtare, për rastet e transporteve të mallrave për llogari të vet;

c) dokument që i jep të drejtën një mjeti për transportin e udhëtarëve, për llogari të vet, brenda dhe jashtë vendit.

Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/autorizimit/certifikates

1. Transporti i mallrave brenda vendit

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	licencë	Bashkia/qarku,
Transporti për llogari të vet	certifikatë	Bashkia
Transporti i mallrave të rrezikshme	certifikatë	DPSHTRR
Transporti me mjete jashtë norme	licencë	DPSHTRR

2. Transporti ndërkombëtar i mallrave

Lloji i veprimtarisë	Dokumenti që lëshohet	Autoriteti kompetent
Transporti për të tretë dhe me qira	Licencë	QKL, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.05.2009
Transporti për llogari të vet	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti i mallrave të rrezikshme	Certifikatë	DPSHTRR
Transporti ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të ECMT/CEMT	Autorizim	ANALTIR

”

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkretë, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik të posedojnë mjetet përkatëse, të pajisura me dokumentacionin e duhur, për të realizuar kontratën objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i

dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni vëren se autoriteti kontraktor, ndër të tjera, për për mjetet motorike vetëshkarkuese ka kërkuar Certifikatë transporti për transport mallrash dhe Licensë transporti (nëse mjete është i marrë me qera duhet të jetë i pajisur me licensë transporti për transport mallrash për të tretë dhe me qera), por në asnjë rast nuk ka specifikuar nëse licencat apo certifikatat e transportit duhet të jenë të lëshuara për transport mallrash brenda vendit apo ndërkombëtar.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentacioni të paraqitur nga ankimuesi, në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se dokumentacioni i paraqitur për mjetin AA 263ML, i marrë me qira nëpërmjet kontratës së qirasë, nr.7622rep., nr.1332kol., datë 06.11.2020, është tërësisht në përputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Akoma më tej, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi, për mjete në pronësi të tij, përkatësisht certifikatave të transportit për secilin mjet, të cilat janë lëshuar në bazë të licencës LN-9200-20-2015, lëshuar nga QKL për subjektin “4 A-M” sh.p.k., me objekt “Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë dhe me qera”, Komisioni konstaton se në këto certifikata përcaktohet si vijon: *“Kjo certifikatë është e vlefshme edhe për transportin e mallrave për të tretë dhe qira brenda vendit si dhe për transportin e mallrave për llogari të vetë brenda dhe jashtë vendit”*. Në këto kushte, Komisioni gjykon se për sa kohë me anë certifikatave të transportit të paraqitura, operatori ekonomik ankimues mund të ushtrojë aktivitetin e transportit të mallrave edhe brenda vendit për të tretë dhe me qira, atëherë edhe licenca LN-9200-20-2015, lëshuar nga QKL për subjektin “4 A-M” sh.p.k., është më se e vlefshme për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për transportin rrugor. Nga ana tjetër, Komisioni gjykon se për autoritetin kontraktor, qëllimi kryesor është garantimi që operatorët ekonomik posedojnë mjetet vetëshkarkuese të pajisura me dokumentacionin e duhur në mënyrë që të zbatojnë me sukses kontratën objekt prokurimi, si dhe të mos krijojnë problematika me autoritetet përkatëse ligjzbatuese. Në këtë kuadër, referuar Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 të Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, me anë të dokumentacionit të paraqitur, operatori ekonomik ankimues mund të ushtrojë aktivitetin e transportit të mallrave për të tretë dhe me qira brenda vendit, e për rrjedhojë e përmbush kriterin e vendosur në shtojcën 13, pika 2.3.d, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, pretendimi e operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 42 e vijues të Ligjit Nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me nr. REF-77140-10-29-2020, me objekt: “Transporti i materialeve të dala nga shembja e objekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019”, me fond limit 76,455,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “4 A-M” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “4 A-M” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1523 protokoli Datë 18.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri